



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA  
GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARTVO PRAVDE  
MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Bi.No: 01-195  
Data/Datum/Date: 07 / 02 / 20 24  
Shtojca/Dodaci/Annex: -3-  
PRISHTINË/A

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
AKADEMIA E DREJTËSISË  
ACADEMY OF JUSTICE

Njësia, Org.  
Org. Jedn.  
Org. Unit

Nr. Prot.  
Br. Prot.  
Prot. No. 120

Nr. Faqeje  
Br. Stranica  
No. Pages 03

Data  
Datum  
Date 07.02.2024  
Prishtinë / a

## MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT

në mes të

MINISTRISË SË DREJTËSISË;

AKADEMISË SË DREJTËSISË

dhe

ODËS SË NDËRMJETËSUESVE TË KOSOVËS

Prishtinë, shkurt 2024

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit ka për qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të palëve nënshkruese, në ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme (*ri-freskuese*) për ndërmjetësuesit e licencuar në Republikën e Kosovës, me qëllim të paisjes së tyre me njohuri të avancuara për realizimin e ndërmjetësimit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 2**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Drejtësisë**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Drejtësisë, janë:
  - 1.1 Alokimi i mjeteve financiare tek Akademia e Drejtësisë për kompensimin e trajnuesve vendorë të certifikuar nga Akademia e Drejtësisë dhe ekipi i FMCS, për realizimin e pagesës së trajnerëve vendorë në përputhje me tarifat për kompensimin e trajnuesve të përcaktuara me vendim të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë dhe konform Rregullores për Trajnues dhe Mentor;
  - 1.2 Pajisja e ndërmjetësuesve me certifikatë për përfundimin me sukses të trajnimit ri-freskues, në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë;
  - 1.3 Caktimi i pikës së kontaktit për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta të palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje.

## **Neni 3**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Akademisë së Drejtësisë**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Akademisë së drejtësisë, janë:
  - 1.1 Përgatitja e programit të trajnimit në bashkëpunim me Odën e Ndërmjetësuesve të Kosovës;
  - 1.2 Përzgjedhja e trajnerëve vendorë;
  - 1.3 Sigurimi i mbështetjes teknike dhe administrative për trajnerët dhe ndërmjetësuesit;
  - 1.4 Caktimi i pikës së kontaktit për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta të palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje.

## **Neni 4**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Odës së Ndërmjetësuesve të Kosovës**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Odës së Ndërmjetësuesve të Kosovës, janë:
  - 1.1 Përpilimi i listave të ndërmjetësuesve të cilët duhet t'i nënshtrohen trajnimeve ri-freskuese, sipas legjislacionit në fuqi;
  - 1.2 Bashkëpunimi me Akademinë e Drejtësisë në hartimin e programit të trajnimit bazuar në nevojat e avancimit profesional të ndërmjetësuesve;

1.3 Caktimi i pikës së kontaktit për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta të palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje.

#### Neni 5

#### Vendi dhe kohëzgjatja e ofrimit të trajnimeve

Trajnimet ri-freskuese për ndërmjetësuesit e licencuar në Republikën e Kosovës, mbahen në forma regjionale brenda Republikës së Kosovës ashtu siç e vlerëson Akademia e Drejtësisë dhe ekipi i FMCS në kohëzgjatje prej tri (3) ditësh.

#### Neni 6

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çfarëdo paqartësie eventuale apo mosmarrëveshje mes palëve lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga kjo marrëveshje, zgjidhet nga palët në mënyrë miqësore.

#### Neni 7

#### Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët dhe vlen deri në përfundimin e Programit të trajnimit të ndërmjetësuesve për vitin 2024.

**Për Ministrinë e Drejtësisë:**

Znj. Albulena Haxhiu, Ministre

**Për Akademinë e Drejtësisë:**

Z. Enver Fejzullahu, Drejtor Ekzekutiv

**Për Odën e Ndërmjetësuesve të Kosovës:**

Znj. Ganimete Xhelili, Kryetare

Prishtinë

07/02/2024